



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Prill 2021

Nr. 337

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidatës për deputete zj. Edona Bilali, për shkelje të parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Kërkues: Organizata fitimprurëse “Qëndresa Qytetare”

Ndaj: Kandidates për deputete, zj. Edona Bilali

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi paraprak

Në ndërfaqen “Aktivitete të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 19.03.2021, nga Organizata fitimprurëse “Qëndresa Qytetare”, është raportuar denoncimi me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi 2370, për një aktivitet të datës 18.03.2021, të kandidatës për deputete të Partisë Socialiste zj. Edona Bilali, në ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër. Sipas denoncuesit zj. Bilali, ka takuar drejtuesin e institucionit dhe banorët e kësaj shtëpie duke shkelur haptazi nenin 91, pika 1 të



ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 3 pika “c” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3853 prot., datë 15.04.2021, i ka kërkuar Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër, informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti, të kandidatës për deputete, zj. Edona Bilali, në ambientet e këtij institucioni.

Me shkresën nr. 142 prot., datë 22.04.2021, administruar me tonën me nr. 3853 prot., datë 24.04.2021, Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve, z. Fatjon Hoxha, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije se zj. Bilali ka shprehur gjithmonë interes lidhur me mirëqenien e banorëve të Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër, duke realizuar me ta biseda miqësore që nuk kanë pasur asnjëherë karakter politik, në mënyrë të vazhdueshme prej vitesh. Ashtu siç çdo vizitë tjetër, edhe vizita e realizuar në datën 18 Mars 2021 prej saj, ishte një vizitë miqësore për t’u interesuar mbi shëndetin e të moshuarve të këtij institucioni, pas një periudhe të gjatë izolimi dhe kryerjes së vaksinimit të tyre. Biseda nuk ka pasur asnjë konotacion politik. Për më tepër nuk është zhvilluar gjatë fushatës zgjedhore pasi siç dihet, kjo e fundit startoi në datën 24.03.2021.



III. Analiza ligjore

Referuar nenit 91 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

Referuar dispozitës së mësipërme, në mënyrë të tillë që të jemi në kushtet e zbatueshmërisë së kësaj dispozite, duhet që:

- Të përdoren në mënyrë të detyruar në fushatë zgjedhore administrata e institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore,
- Të përdoren në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor, nxënësit e sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore;
- T’ju premtohet ose ofrohet përfitime nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Për sa më sipër, të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, përbëjnë burim njerëzor të institucionit por nuk konsiderohen pjesë e administratës së tij, as nuk janë nxënës të sistemit shkollor parauniversitar dhe as nëpunës publikë.



Në shqyrtim të fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton e provuar se takimi i zhvilluar nga zj. Bilali me të moshuar të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, përbën përdorim të “burimeve njerëzore” në kuptim të nenit 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, referuar nenit 3, pika “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikon se:

- “veprimtari të ndaluara” janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

Përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Për sa më sipër, që ky takim i zj. Bilali të jetë në kushtet e përcaktuara nga neni sipërcituar, duhet të jetë zhvilluar në fushatë zgjedhore.

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se:

“ Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.”

Referuar si të dhënave të denoncuesit ashtu dhe përgjigjes së drejtorit të Shtëpisë së të Moshuarve SHkodër, z. Hoxha, ky takim i zj. Bilali në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, është zhvilluar në datën 18 Mars, para fillimit të fushatës zgjedhore.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga organizata jofitimprurëse “Qëndresa Qytetare” pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e zj. Edona Bilali, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe nenet 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit



nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj kandidates për deputete zj. Edona Bilali, pasi nuk konstatohen shkelje të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

